



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Infrastrukturës
Ministarstvo Infrastrukture
Ministry of Infrastructure

Ministri i Infrastrukturës, në mbështetje të nenit 93 (4) të Kushtetutës të Republikës së Kosovës, në pajtim me nenin 8, paragrafin 1.2 dhe nenin 65, paragrafin 2, nenin 52, 61, 64 të Ligjit nr. 04/L-063 mbi Hekurudhat e Kosovës, nenin 38, paragrafi 6 të Rregullores 09/2011 të punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës. dhe nenit 8, paragrafi 1.4 të Rregullores nr. 02/2011 mbi fushat e përgjegjësive administrative të Zyrës së Kryeministrat dhe ministrave.

Nxjerr:

**UDHËZIMIN ADMINISTRATIV NR. 02/2013
PËR LLOGARITJEN E SHPENZIMEVE TË DREJTPËRDREJTA PËR
MIRËMBAJTJEN E INFRASTRUKTURËS HEKURUDHORE**

**Neni 1
Qëllimi**

1. Nxjerra e këtij Udhëzimi Administrativ ka për qëllim që të përcaktohet mënyra e llogaritjes së kostove direkte të Menaxherit të Infrastrukturës Hekurudhore për mirëmbajtjen e kësaj infrastrukturre, në mënyrë që të bëhet llogaritja e tarifave të shfrytëzimit të rrjetit hekurudhor të Kosovës nga ndërmarrjet hekurudhore të cilat operojnë me trena për transportin e udhëtarëve dhe mallrave.

2. Mënyra e krijimit të metodës së pagesave për menaxherët e infrastrukturës së shfrytëzimit të përbashkët e pëershkuar në nënreun V të Ligjit mbi Hekurudhat "Pagesat e Infrastrukturës", pagesat e infrastrukturës për pakon minimale të qasjes, qasjen në linjat e pajisjeve shërbuese dhe shërbimet furnizuese të paraqitura në Nenin 52 paragrafët 4.1 dhe 4.2, duhet të caktohen sipas kostove të cilat shkaktohen si rezultat i shërbimeve të operimit të trenit dhe mirëmbajtjes së infrastrukturës

hekurudhore. Ky Udhëzim Administrativ e bënë detajizimin e elementeve të cilat duhet të merren në konsiderim si kosto direkte.

Neni 2
Kompetencat dhe fusha e zbatimit

1. Ministria e Infrastrukturës është përgjegjëse për përcaktimin e elementeve të kostove të cilat konsiderohen si kosto direkte për llogaritjen e pagesave të infrastrukturës mbi bazat e parimeve të Direktivës së BE-së 2001/14.
2. Ministria do të bënë modifikimin e elementeve të kostove atëherë kur Komisioni Evropian të përcakton modalitetet për llogaritjen e kostove sipas direktivës së re të cilat shkaktohen drejtpërsëdrejti si rezultat i operimit me trena.
3. Menaxherët e Infrastrukturës së Shfrytëzimit të Përbashkët duhet t'i shfrytëzojnë elementet e kostove direkte për llogaritjen e pagesave të infrastrukturës për shërbimet të cilat përfshihen në pakon minimale të qasjes.
4. Menaxherët e Infrastrukturës nuk janë të obliguar që ta përdorin sistemin e kostove direkte të përcaktuar në këtë Udhëzim Administrativ për shërbimet shtesë dhe shërbimet ndihmëse të definuara në nenin 52, paragrafët 4.3 dhe 4.4. si dhe për shërbimet të cilat rezultojnë nga qasja në pajisjet e trajnimit në sens të nenit 53, paragrafit 6 të Ligjit mbi Hekurudhat.

Neni 3
Sistemi i kostove direkte

1. Menaxheri i Infrastrukturës duhet ta krijoj sistemin e ndarë të kostove direkte për infrastrukturën e tij i cili duhet të përfshijë organizimin e kostove si në vijim:

- 1.1. Kategoritë e kostove direkte ;
- 1.2. Qendrat e kostove direkte

Neni 4
Kategoritë kryesore të kostove direkte

1. Kategoritë kryesore të kostove direkte përfshijnë:

- 1.1. Kostot e mirëmbajtjes së binarëve dhe pjesëve të tyre përbërëse, duke përfshirë matjen dhe rregullimin e gjometrisë së binarëve, zëvendësimin e shinave,

skambjeve dhe kryqëzimeve, si dhe zëvendësimi i traversave dhe balastit në linjat hekurudhore;

- 1.2. Kostot e mirëmbajtjes së urave, tuneleve dhe lëshesave;
- 1.3. Kostot e mirëmbajtjes së vendkalimeve;
- 1.4. Kostot e mirëmbajtjes së objekteve siç janë stacionet, terminalet e mallrave, stacionet përbledhëse, vendet për formimin e trenave, binarët e parkimit, mirëmbajtja dhe objektet tjera teknike, si dhe objektet tjera relevante hekurudhore përgjatë linjave hekurudhore;
- 1.5. Kostot e mirëmbajtjes së makinave për mirëmbajtjen e binarëve;
- 1.6. Kostot e mirëmbajtjes së stabilimenteve tjera për mirëmbajtjen e linjave hekurudhore përvèç makinave për mirëmbajtjen e binarëve;
- 1.7. Kostot e mirëmbajtjes të stabilimenteve për mirëmbajtjen e objekteve siç janë stacionet, terminalet e mallrave, stacionet përbledhëse, vendet për formimin e trenave, binarët e parkimit, mirëmbajtja dhe objektet tjera teknike, si dhe objektet tjera relevante hekurudhore përgjatë linjave hekurudhore;
- 1.8. Pagat e stafit ekzekutiv i cili vepron drejtpërsëdrejti në mirëmbajtje dhe operimet e trafikut, duke përfshirë këtu sinjalizimin, rregullimin, përcjelljen, komunikimin dhe ofrimin e informatave për lëvizjen e trenave si dhe informatat tjera të kërkuara për zbatimin dhe operimin me shërbimet për të cilat është dhënë qasja;
- 1.9. Pagat e stafit ekzekutiv i cili vepron drejtpërsëdrejti në mirëmbajtje dhe operimet e trafikut në objektet siç janë stacionet, terminalet e mallrave, stacionet përbledhëse, vendet për formimin e trenave, binarët e parkimit, mirëmbajtja dhe objektet tjera teknike, si dhe objektet tjera relevante hekurudhore përgjatë linjave hekurudhore;
- 1.10. Kostot operative të infrastrukturës dhe objekteve siç janë stacionet, terminalet e mallrave, stacionet përbledhëse, vendet për formimin e trenave, binarët e parkimit, mirëmbajtja dhe objektet tjera teknike, si dhe objektet tjera relevante hekurudhore përgjatë linjave hekurudhore;

- 1.11. Kostot e mirëmbajtjes së pajisjeve të sinjalizimit, CTC-së, telekomunikacionit, energjetikës, duke përfshirë kabllot dhe elementet tjera mbështetëse;
- 1.12. Kostot e karburanteve, vajrave dhe pjesëve rezervë për pajisjet e destinuara për mirëmbajtje dhe organizim të operimeve të trafikut;
- 1.13. Kostot e amortizimit të pajisjeve të destinuara për mirëmbajtje dhe organizim të operimeve të trafikut;
- 1.14. Kostot e amortizimit të mjeteve lëvizëse hekurudhore dhe rrugore të destinuara për mirëmbajtje dhe operimet me trafik;
- 1.15. Menaxheri i infrastrukturës është i lirë të bënë detajizimin e mëtejshmë të kategorive të kostove të paraqitura nën paragrafin 1 për nevojat e tij të brendshme me qëllim të përmirësimit të transparencës dhe efikasitetit të sistemit të llogaritjes së kostove.

Neni 5
Qendrat kryesore të kostove direkte

1. Kategoritë e kostove direkte kryesore duhet të alokohen në qendrat e kostove direkte.
2. Qendrat kryesore të kostove direkte për shërbimet e përfshira në pakon minimale të qasjes janë:
 - 2.1. Mirëmbajtja e linjave hekurudhore, skambjeve dhe kryqëzimeve;
 - 2.2. Sinjalizimi, telekomunikacioni dhe furnizimi me energji;
 - 2.3. Operimet e trafikut.
3. Qendrat kryesore të kostove direkte për shërbimet të cilat përfshihen në qasjen në pajisjet shërbyese dhe shërbimet furnizuese (atje ku është e aplikueshme) janë:
 - 3.1. Ndërtesat e stacioneve;
 - 3.2. Terminalet e mallrave;
 - 3.3. Stacionet përbledhëse;
 - 3.4. Vendet për formimin e trenave;
- 3.5. *Binarët për parkim;*

3.6. Pajisjet për furnizim me karburante

3.7. Pajisjet e mirëmbajtjes dhe pajisjet tjera teknike;

4. Menaxheri i infrastrukturës është i lirë të bënë detajizimin e mëtejshmë të kategorive të kostove të paraqitura nën paragrafin 2 dhe 3 për nevojat e tij të brendshme me qëllim të përmirësimit të transparencës.

**Neni 6
Përjashtimi i kostove**

1. Kostot direkte të shërbimeve të trenit të cilat janë të ndërlidhura me konsumimin e infrastrukturës hekurudhore duhet t'i përjashtojnë kategoritë vijuese të kostove:

1.1. Kostot e investimeve kapitale, duke përfshirë pagat e punonjësve dhe pensionet;

1.2. Pagesat e interesit mbi investimet kapitale;

1.3. Amortizimin (zhvleftësimin) e pajisjeve të informimit, komunikimin, ose telekomunikimit;

1.4. Kostot lidhur me menaxhimin e pronës, në veçanti përvetësimin, shitjen, çmontimin, dekontaminimin rikultivimin, dhënien e tokës me qira, apo të aseteve tjera fiks;

1.5. Shërbimet sociale, shkollat, çerdhet e fëmijëve, restorantet;

1.6. Kostot lidhur me forcat madhore, aksidentet, çrregullimin e shërbimeve.

**Neni 7
Hyrja në fuqi**

Ky Udhëzim Administrativ do të hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga ana e Ministrit të Infrastrukturës.

Prishtinë,

20.06.2013

Fehmi Mujota,

Ministër i Ministrisë së Infrastrukturës

